



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA LËVIZJA E LEGALITETIT” PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Lëvizja e Legalitetit” nëpërmjet Kryetarit, Z. Shpëtim Axhani, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2024.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 19.02.2025, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Lëvizja e Legalitetit”, me iniciale “PLL”, me Kryetar Z. Shpëtim Axhani, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Lëvizja e Legalitetit” me shkronja nistore “PLL”, me adresë Rruga "Muhamet Gjollësia", Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Shpëtim Axhani, me adresë Rruga "Don Bosko", Nd. 170, Ap. 1, 1962/414, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Z. Fatmir Haveriku, me adresë Lgj. 2, Kavajë
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është Z. Ferit Nela, me adresë Rruga "Ullishtes", Sauk, Nr. 19, Tiranë
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Lëvizja e Legalitetit”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Lëvizja e Legalitetit”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Licela VELIU -Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina DOÇAJ -Drejtorja e Ligjshmërisë

Majlinda ÇELMETA -Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)